



Prishtinë, 01.07.2020

**Për: Kryeministrin e Republikës së Kosovës**

**Ambasada Amerikane**

**Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian**

**Zëvendës Kryeministri**

**Zyra për Qeverisje të Mirë**

**Misioni i OSBE-së në Kosovë**

**KOMUNIKATË PËR GJENDJEN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN GJATË PANDEMISË DHE NEVOJA PËR GJITHËPËRFSHIRJEN E TYRE ME THEKS TË VEÇANTË NË FONDIN PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE**

Ne organizatat e shoqërisë civile që angazhohemi për të drejtat, gjithë përfshirjen dhe avancimin e pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, në nivel qendror dhe lokal, me anë të kësaj shkrese zyrtare duam të informojmë Kryeministrin e Republikës së Kosovës për gjendjen e rëndë aktuale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian gjatë Pandemisë COVID 19 dhe nevojat e tyre emergjente për tu asistuar/përfshirë financiarisht me fondin e paraparë për rimëkëmbje ekonomike të Republikës së Kosovës. Meqenëse komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë pjesë e grupeve më të cenueshme, do të duhej të kenë vëmendje specifike dhe i gjithë procesi të bëhej në koordinim me organizatat e shoqërisë civile që merren me të drejtat e komuniteteve; kur jemi te komunitetet, një vëmendje e veçantë do të duhej ti kushtohet edhe masave për mbështetje të punësimit/rritjen e punësimit te grupet e punëtorëve të komuniteteve me gjasa më të ultë për punësim.

Duke marre parasysh statistikat e siguruar nga Ministria e Administratës Publike në dhjetor të vitit 2018, në 56 institucione publike kanë qenë të punësuar 30,635 persona, nga të cilët vetëm 113 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian apo 0.36%. Kërkojmë nga institucionet relevante të ndërmarrin masat konkrete fillimisht për të respektuar kuotën e paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës neni 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike] dhe Ligji për Shërbim Civil nr 03/L-149 neni 11 [Pranimi në Shërbimin Civil, Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, si dhe Rregulloren Nr.04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë.

Hap tjetër i Kryeministrit në të mirë të komuniteteve në Kosovë do të ishte edhe përfshirja e organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e komuniteteve në të gjitha grupet punuese ku do të diskutohet mirëqenia e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Për më tepër, rrjetet e organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e komuniteteve bashkërisht dhe OJQ-ët në mënyrë vetanake kanë asistuar familjet e këtyre komuniteteve gjatë fazës emergjente me ndihma esenciale dhe këndvështrimi dhe rekomandimet e tyre për zbatimin e fondit në terren do të jenë thelbësore.

Kërkojmë nga Kryeministri i Republikës së Kosovës zotimin për transparencë në këtë proces dhe njëherit edhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në veçanti në trajtimin e komuniteteve.

Për fund, ne anëtarët e organizatave të shoqërisë civile kërkojmë nga Kryeministri të marrë hapat e nevojshëm për llogaridhënie nga Ministritë e linjave në raport me trajtimin e komuniteteve, me theks të veçantë me fondin e paraparë për rimëkëmbje si dhe të caktohet një takim në mes të Kryeministrit të Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile për të shprehur qëndrimet dypalëshe sa i përket Fondit për Rimëkëmbje Ekonomike dhe për të ritheksuar gatishmërinë e organizatave të shoqërisë civile për bashkëpunim në çështjet me interes të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

**Letra është iniciuar nga Organizatat partnere:**

Syri i Vizionit

Ballkan Sunflowers

Voice of Roma, Ashkali and Egyptians

Roma and Ashkalia Documentation Center



**Mbështetur:**

Bethany Christian Services-Kosova

ROMA IN ACTION

Women's Alliance for Integration"

SHL Kosova

Nevo Koncepti

Roma Versitas Kosovo

Përparimi Rinor i Ashkalive të Mitrovicës "PRAM"

BRAN - Bashkimi Rinor E Ardhmja E Ndritur

The Ideas Partnership